

GJYKATA SUPREME

Prishtinë

Numri i lëndës: **Pml-Kzz 42/2017**
(P Nr. 938/13 Gjykata Themelore e Mitrovicës)
(PAKR Nr. 445/15 Gjykata e Apelit)


Data: **10 maj 2017**

Gjykata Supreme e Kosovës, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Krassimir Mazgalov (kryetar dhe gjyqtar referues), gjyqtari i EULEX-it Arnout Louter dhe gjyqtarja e Gjykatës Supreme Emine Mustafa, si anëtarë të kolegjit, dhe zyrtarja ligjore e EULEX-it Sandra Gudaityte, si proces-mbajtëse, në lëndën penale kundër, ndër të tjerë, të pandehurit

S **S**, i lindur më : të Komunës së Skënderajt, tani banues në , aktualisht duke kryer dënimin e tij në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë;

i akuzuar sipas Aktakuzës PPS 88/11 të datës 8 nëntor 2013 (në tekstin e mëtejshëm “Aktakuza”) me 7 (shtatë) akuza për Krime Luftë kundër Popullatës Civile, në kundërshtim me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 44, datë 8 tetor 1976) (në tekstin e mëtejshëm: KPRSFJ) (tani veprë e dënueshme sipas neneve 31 dhe 152 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK) dhe në kundërshtim me nenet e përbashkëta 3 dhe 4 të Protokollit Shtesë II, të gjitha rregullat e së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm në Kosovë dhe në çdo kohë që lidhet me Aktakuzën;

duke vepruar lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësit **G**
D. G **S** dhe **C** **R** në emër të të pandehurit **S** **S** më 13 shkurt 2017



pasi shqyrtoi përgjigjen ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (në tekstin e mëtejme “Prokuroria”) më 7 mars 2017;

pasi u këshillua dhe votoi më 10 maj 2017;

në bazë të neneve 432, 433 dhe 435 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPP)

merr këtë


AKTVENDIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur nga mbrojtësit G D. G -S dhe C R në emër të të pandehurit S S më 13 shkurt 2017, hidhet poshtë si e palejueshme.

ARSYETIM

I. Historia Procedurale

1. Më 8 nëntor 2013, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme “PSRK”) ngriti Aktakuzën kundër S S dhe të pandehurit tjetër, duke e akuzuar atë me 7 (shtatë) akuza për Krime Lufte kundër Popullatës Civile, në kundërshtim me nenet 22 dhe 142 të KPRSFJ-së (aktualisht vepër e dënueshme nga nenet 31 dhe 152 të KPK-së) dhe në kundërshtim me nenet e përbashkëta 3 dhe 4 të Protokollit Shtesë II, të gjitha rregullat e së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm në Kosovë dhe në çdo kohë të lidhur me Aktakuzën.
2. Shqyrtimi gjyqësor filloi më 22 maj 2014 dhe përfundoi më 27 maj 2015. Ai përfshiu 46 seanca gjyqësore. Më 27 maj 2015, Gjykata Themelore e Mitrovicës shpall Aktgjykimin e



saj P 938/13. S S u shpall fajtor për këtë veprë penale: gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, në disa raste, në gusht dhe shtator 1998, duke vepruar si anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejme "UÇK"), shkeli rëndë Nenin 3 të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, sepse ai kreu me dashje dhunë, trajtim mizor dhe torturë kundër Dëshmitarit A, një civil shqiptar i Kosovës i paraburgosur në objektin e burgimit të UÇK-së në (komuna Skenderaj), i cili nuk merrte pjesë aktive në ushtri, duke e goditur atë me grushte dhe shuplaka brenda qelisë së paraburgimit, dhe ky veprim sipas nenit 33 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës klasifikohet si krim lufte në vazhdimësi, në bazë të neneve 152 (1) dhe 2) (2.1) dhe 81 (1) të KPK-së, në kundërshtim me nenin 4 (2) (a) të Protokollit Shtesë II të Konventave të Gjenevës (në tekstin e mëtejme e quajtur "Akuza II" bazuar në numrin e paragrafit të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore), dhe u dënua me 6 (gjashtë) vite burgim. I pandehuri u lirua nga veprat penale të detajuara në 4 (katër) akuzat e tjera.


3. Më 7 gusht 2015 dhe 10 gusht 2015, PSRK dhe mbrojtësit e S S paraqitën ankesat e tyre kundër Aktgjykimit P 938/13 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës.
4. Më 15 shtator 2016, Gjykata e Apelit shpalli Aktgjykimin PAKR 455/15. Gjykata e Apelit e pranoi ankesën e mbrojtësve të S S dhe hodhi poshtë akuzën kundër të pandehurit të përshkruar në Akuzën II, pasi ajo ishte pjesë materiale, faktike e një vepre penale në vazhdimësi për të cilën i pandehuri ishte dënuar më parë. Më tej Gjykata e Apelit miratoi pjesërisht ankesën e PSRK-së dhe e ndryshoi Aktgjykimin P 938/13 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës duke i shpallur të pandehurit S S dhe J D fajtorë për këtë veprë penale: gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, në një rast midis fillimit të gushtit dhe fundit të shtatorit 1998, duke vepruar si pjesëtarë të UÇK-së dhe në bashkë-kryerje me njëri-tjetrin siç përkufizohet në Nenin 31 të KPK-së, shkelën me dashje integritetin trupor dhe shëndetin e një mashkulli shqiptar të paidentifikuar nga zona e në Mitrovicë, i paraburgosur në qendrën e paraburgimit në , duke e rrahur atë në mënyrë të përsëritur, veprim i klasifikuar si krim lufte në bazë të Nenit 152(1) dhe (2) (2.1), (2.2) të KPK-së dhe në shkelje të Nenit 4(2)(a) të Protokollit Shtesë II të Konventave të Gjenevës, lidhur me Nenin 33(2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme e quajtur "Akuza IV" bazuar në numrin e paragrafit të dispozitivit të Aktgjykimit të

Gjykatës Themelore). Gjykata e Apelit e dënoi S S për këtë vepër penale me 5 (pesë) vite dhe 3 (tre) muaj burgim. Gjykata e Apelit më tutje e ndryshoi Aktgjykimin P 938/13 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës duke i shpallur të pandehurit S S dhe S L fajtorë dhe duke e liruar të pandehurin S J nga kjo vepër penale: në cilësinë e tyre si pjesëtarë të UÇK-së dhe persona që ushtronin kontroll mbi qendrën e paraburgimit në , në bashkëpunim me njëri-tjetrin, siç përcaktohet në Nenin 31 të KPK-së, ata shkelën integritetin trupor dhe shëndetin e një numri civilësh shqiptarë të paidentifikuar të mbajtur në këtë qendër paraburgimi, duke i mbajtur ata në mjedise të papërshtatshme, në kushte të mungesës higjieno-sanitare, ushqimit të pamjaftueshëm, duke u shkakuar rrahje të herëpashershme, të paktën gjatë gushtit dhe shtatorit 1998, vepër e klasifikuar si krim lufte sipas Nenit 152(1) dhe (2)(2.1), (2.2) të KPK-së, dhe, në rastin e S L lidhur me Nenin 161(1)(1.1) të KPK-së, të dy në shkelje të Nenit 4(2)(a) të Protokollit Shtesë II të Konventave të Gjenevës, lidhur me Nenin 33(2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme e quajtur “Akuza IX” bazuar në numrin e paragrafit të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore). Për këtë vepër penale S S u dënua me 8 (tetë) vite burgim. Në bazë të Neneve 80(1) dhe (2.2), dhe 82(1) të KPK-së dhe duke marrë parasysh dënimin e caktuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në lëndën PAKR 456/2015 datë 14 shtator 2016, S S iu shqiptua dënimi unik me 10 (dhjetë) vite burgim.

5. Më 13 shkurt 2017, mbrojtësit e të pandehurit S S paraqitën kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, duke i kërkuar Gjykatës Supreme të prapësonte të gjitha kontradiktat në Aktgjykimet e kundërshtuara dhe të hidhte poshtë të gjitha akuzat kundër të pandehurit, ose, nga ana tjetër, ta kthente lëndën për rigjykim në lidhje me të gjitha akuzat.
6. Më 7 mars 2017, Prokuroria paraqiti përgjigjen e saj ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësit në emër të të pandehurit S S , në të cilën i kërkohet Gjykatës Supreme ta hedhë poshtë kërkesën si të pabazuar.

II. Parashtrësit e palëve

Parashtrësit në emër të



7. Mbrojtja pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, PAKR 455/15 datë 15 shtator 2016, është i bazuar në standarde ligjore të zbatuara në mënyrë të pasaktë dhe kundërthënëse, dështimin për të shqyrtuar të shkresat provuese në tërësi, dhe keqinterpretimet për provat konkrete të shqyrtimit gjyqësor, dhe përmban gabime ligjore. Prandaj, mbrojtja i kërkon Gjykatës Supreme të prapësojë dënimet dhe të hedhë poshtë të gjitha akuzat kundër të pandehurit S S ose, si alternativë, ta kthejë lëndën për rigjykim lidhur me të gjitha akuzat.
8. Mbrojtja pretendon se Gjykata e Apelit dështoi të jepte mendim të arsyetuar kur refuzoi të trajtonte ose zgjidhte kërkesën për hetim të mënyrës së parregullt në formimin e trupit gjykues. Në këtë drejtim, mbrojtja ngre një numër pretendimesh lidhur me përbërjen e trupit gjykues në një lëndë tjetër të shqyrtuar nga Gjykata Themelore e Mitrovicës, II (P 58/14) dhe kërkon të caktohet një seancë dëgjimore për hetimin e këtyre parregullsive.
9. Me tej mbrojtja pretendon se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit gabuan kur deklaruan se nuk kishte shkelje të ligjit në dështimin e trupit gjykues për të siguruar mbajtje fjalë për fjalë të proces-verbaleve të shqyrtimit gjyqësor. Mbrojtja pretendon se nuk pati mbajtje fjalë për fjalë të proces-verbaleve në shqyrtimin gjyqësor. Nuk pati baza të arsyeshme për të refuzuar kërkesën e mbrojtjes për të lejuar mbajtje fjalë për fjalë të proces-verbaleve me regjistrime audio-pamore ose stenografike. Nuk ka shkresa që tregojnë se proces-verbale të shtypura të shqyrtimit gjyqësor janë të sakta dhe nëse ato pasqyrojnë ndryshime në përkthime. Mungesa e mbajtjes fjalë për fjalë të proces-verbaleve në shqyrtime gjyqësore të ndërlikuar të krimeve të luftës, ku provat përbëhen vetëm nga dëshmitë e dëshmitarëve cenojnë aftësinë për të përcaktuar plotësisht dhe me objektivitet besueshmërinë, sigurinë dhe mjaftueshmërinë e provave. Dështimi për të mbajtur proces-verbale të sakta minoi të drejtat e të akuzuarve. Së dyti, kryetari i trupit gjykues i cili monitoroi dhe korrigjoi proces-verbale shkeli detyrimet etike që gjyqtari duhet të jetë i paanshëm. Prandaj, refuzimi për të mbajtur proces-verbale fjalë për fjalë shkeli të drejtat themelore të të pandehurit. Gjykata e Apelit gaboi në arritjen e përfundimit se nuk kishte pasur shkelje.



10. Aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë shkelën të drejtën vendore dhe ndërkombëtare duke e lejuar PSRK-në të përdorë deklaratat të pasakta dëshmitarësh në procedurën paraprake. Këta dëshmitarë janë Dëshmitari A, F M., Dëshmitari F, Dëshmitari B, Dëshmitari I, Dr. B G., dhe Dëshmitari C. Dëshmitarëve iu kërkua të nënshkruajnë deklaratat që nuk u ishin përkthyer. Gjykata Themelore u mbështet në mënyrë të gabuar në këto deklaratat të dhëna në procedurën-paraprake, duke i miratuar statusin e dëshmitarit “armiqësor” njërit prej dëshmitarëve të PSRK-së, dhe duke vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarit. Mbrojtja pretendon se ajo i paraqiti Gjykatës së Apelit prova të reja lidhur me dëshminë e një zyrtari ligjor të EULEX-it në lëndën Prokurori kundër M. Z dhe R. R lidhur me mënyrën e regjistrimit të deklaratave në procedurën-paraprake nga Prokurori i EULEX-it. Këto prova vërtetojnë se deklaratat e dhëna në procedurën-paraprake në këtë lëndë nuk janë të sakta. Megjithatë, sipas mbrojtjes, Gjykata e Apelit refuzoi ta trajtonte këtë çështje dhe pretendoi se mbrojtja thjesht e kundërshtoi papranueshmërinë e përgjithshme të deklaratave të dhëna në procedurën-paraprake.
11. Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit nuk zbatuan standardet ndërkombëtare dhe vendore të cilat kërkojnë vërtetimin e akuzave penale përtej dyshimit të arsyeshëm. Ajo nuk i vlerësoi provat në tërësi, mori parasysh vetëm prova të përzgjedhura, dhe kështu shkeli parimin *in dubio pro reo*.
12. Më tej Mbrojtja pretendon se i pandehuri nuk mund të gjendet fajtor për Akuzën IX me teorinë e përgjegjësisë komanduese sepse kjo mënyrë përgjegjësie ligjore nuk është trajtuar asnjëherë nga trupi gjykues. Aktakuza nuk e ka akuzuar asnjëherë S. S me përgjegjësinë e komandimit. Mbrojtja pretendon se S. S u akuzua si bashkë-kryerës për këtë krim; prandaj i pandehuri nuk pati mundësinë të kundërshtonte konceptin e përgjegjësisë së komandimit. Po kështu, Gjykata e Apelit dështoi të vërtetonte elementet e përgjegjësisë së komandimit.
13. Gjykata e Apelit e gjeti në mënyrë të gabuar të pandehurin fajtor për veprën penale të përshkruar në Akuzën IX duke zëvendësuar gjetjet e arsyeshme të bëra nga Gjykata Themelore me përfundimet e veta. Gjykata e Apelit nuk është e autorizuar të kryejë shqyrtim *de novo*; Gjykata nuk mund të rrezojë gjetjet e Gjykatës Themelore vetëm nëse këto gjetje

janë të paarsyeshme. Në shkresat e lëndës nuk ka prova që tregojnë keqtrajtim në paraburgim. Dëshmia e vetme është ajo e dhënë nga Dëshmitari A, dhe ajo nuk është vërtetuar me prova të tjera.

14. Mbrojtja pretendon se edhe dënimi për veprën penale të përshkruar në Akuzën IV duhet hedhur poshtë pasi Gjykata e Apelit përsëri e zëvendësoi arsyetimin e Gjykatës Themelore me mendimet e veta. Gjykata e Apelit u mbështet vetëm në pjesë të përzgjedhura të procesverbaleve të shqyrtimit gjyqësor dhe i shpërfilli të gjitha kundërthëniet në dëshminë e Dëshmitarit A. Më tej, Dëshmitari A është i vetmi person i cili dha dëshmi për personin e paidentifikuar nga zona e në Mitrovicë. Dëshmia e Dëshmitarit A duhet të hidhet poshtë si e pabesueshme për shkak të kundërthënieve dhe kontradiktave.

15. Dënimi i S S mbështetet vetëm në dëshminë e një dëshmitari, dhe Gjykata shpërfilli të gjitha provat që minonin besueshmërinë e dëshmisë së Dëshmitarit A. Gjykata e Apelit nuk trajtoi provat në shkresat e lëndës për sëmundjen mendore të Dëshmitarit A dhe i hodhi poshtë këto prova si jo relevante. Më tej, dëshmia e ekspertit mjekësor të EULEX-it, Dr. B , kundërshtoi drejtpërdrejt dëshminë e Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit K.

Parashtrësit e Prokurorisë

16. Prokuroria në përgjigjen e saj i kërkon Gjykatës Supreme të hedhë poshtë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar. Prokuroria më tej thekson se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm kundër vendimit gjyqësor përfundimtar ose kundër procedurave gjyqësore që kanë paraprirë marrjen e atij vendimi, pasi këto procedura të jenë përfunduar në formë të prerë. Prokuroria thekson se në këtë lëndë, mbrojtja e S S paraqiti ankesë në shkallë të tretë kundër Aktgjykimit PAKR 455/15 të Gjykatës së Apelit. Ankesa është ende në pritje të shqyrtimit, çka do të thotë se vendimi gjyqësor nuk është akoma përfundimtar dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë duhet hedhur poshtë pasi nuk është paraqitur në pajtim me dispozitat e KPP-së.



17. Prokuroria më tej thekson se pretendimet lidhur me përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore lidhen me lëndën (PAKR 456/16; P 58/14). Ndërsa trupi gjykues në këtë lëndë ishte në pajtim me rregullat. Prandaj, Prokurori mëton se ky pretendim nuk duhet të jetë objekt i kësaj kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.
18. Prokuroria pretendon se mungesa e proces-verbaleve fjalë për fjalë nuk përbën arsye për paraqitjen e një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në bazë të neneve 432(1.2) dhe 384(1) të KPP-së. Më tej, edhe sikur kjo të kishte qenë një shkelje e rëndë e ligjit procedural, mbrojtja do të duhej të tregonte se kjo shkelje cenoi ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Në bazë të Nenit 315(2) të KPP-së, kryetari i trupit gjykues ka të drejtë të vendosë për mënyrën se si do të mbahet proces-verbali i shqyrtimit gjyqësor.
19. Prokuroria pretendon se ligji nuk vendos një rregull të rreptë për regjistrimin audio-pamor të dëshmisë në procedurën paraprake. Neni 131(4) i KPP-së është fleksibël në këtë çështje dhe lejon përmbledhjen e intervistës në procedurën paraprake. Më tej, Gjykata Themelore zbatoi rregullat e përcaktuara në Nenin 123(2) të KPP-së dhe nuk i shënoi deklaratat e dhëna në procedurën paraprake në proces-verbal; këto deklarata thjesht u përdorën për të vlerësuar saktësinë dhe besueshmërinë e dëshmive.
20. Më tej, Prokuroria tregon se vlerësimi i provave dhe besueshmërisë së dëshmitarit bie jashtë fushëveprimit të shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

III. Përbërja e trupit gjykues

21. Kolegji përcaktoi se më 28 mars 2017 (KGJK Nr. 90/2017), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "KGJK") konfirmoi se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në këtë lëndë do të gjykohej nga një kolegji i përbërë në shumicë nga gjyqtarë të EULEX-it dhe i kryesuar nga një gjyqtar i EULEX-it.

IV. Gjetjet e kolegjit



22. Kolegji vëren se në bazë të Neneve 418(3) dhe 432(1) të KPP-së, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurave gjyqësore që kanë paraprirë marrjen e atij vendimi pasi procedura është përfunduar në formë të prerë. I vetmi përjashtim i këtij rregulli parashikohet në Nenin 432(4) të KPP-së, që përcakton se *“kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit”* (theksi i shtuar).
23. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, si një ndër mjetet e jashtëzakonshme ligjore, është mjeti përjashtimor ligjor që synon të korrigjojë mundësisht zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale. Kërkesat e rrepta të pranueshmësisë synojnë të sigurojnë që ky mjet ligjor të mos përdoret si një shkallë e tretë e përgjithshme kundër të gjitha vendimeve në procedurën penale. Prandaj, dispozitat e KPP-së lejojnë në mënyrë të rreptë kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë vetëm kundër vendimeve përfundimtare ose pasi procedurat të jenë përfunduar në formë të prerë, me një përjashtim të përcaktuar në Nenin 432(4) të KPP-së. Në vendimet e saj të mëparshme, Gjykata Supreme e ka interpretuar këtë Nen rreptësisht sipas formulimit të ligjit (*shih* Gjykata Supreme e Kosovës, Pml.Kzz 207/14, 6 nëntor 2014, faqet 3 dhe 4; Pml.Kzz 66/2015, 14 maj 2015, paragrafi 4.3; Pml.Kzz 100/2015 dhe 136/2015, 25 qershor 2015, faqe 3).
24. Kërkesa e tanishme për mbrojtje të ligjshmërisë paraqitet kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 455/15, datë 15 shtator 2016. Më 29 dhe 30 nëntor 2016, të pandehurit S . . . S . . . S . . . L . . . dhe J . . . D . . . paraqitën ankesa në shkallë të tretë kundër këtij Aktgjykimi. Ankesat janë ende në pritje të shqyrtimit të tyre në Gjykatën Supreme. Prandaj, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR 455/15 nuk mund të konsiderohet si vendim gjyqësor i formës së prerë. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se rregullat për kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, të përcaktuara në Nenin 432(1) të KPP-së, nuk janë përmbushur. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 455/15 mund të paraqitet vetëm pasi Aktgjykimi të bëhet përfundimtar, që do të thotë vetëm pasi Gjykata Supreme të ketë gjykuar ankesat në shkallë të tretë.



25. Për këtë arsye, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësit G D. G. S. dhe C R në emër të të pandehurit S S më 13 shkurt 2017 hidhet poshtë si e palejueshme.

Nisur nga sa më lart, është vendosur si në dispozitiv.

Kryetar i Kolegjit

Proces- mbajtës

Krassimir Mazgalov
Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte
Oficere ligjore e EULEX-it

Anëtarë të kolegjit

Arnout Louter
Gjyqtar i EULEX-it

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
DOKUMENTI I KOPJËS E VËRTETON
OTPRAVKA POTVRDJUJE
Punëtori i autorizuar
Ovlašćení radník
Emine Mustafa
Gjyqtare e Gjykatës Supreme